KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | April 12th 2024

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

| | |
|---|---|
| **April 16** | **Business Brunch**, by KDWV |
| **April 16-19** | **Cluster Meetings**, by KDWV |
| **April 17** | **Business After Hours**, by KDWV |
| **April 19** | **Launching Event of the Position Paper: "Challenges of Accessing the Labour Market – Middle -Aged Women in Kosovo",** by KDWV and FNF |
| **April 22-26** | **Hannover Messe 2024** |
| **April 24** | **N4CEB Business Breakfast** |
| **April 24-25** | **FIxBE-Fintech Berlin** |
| **April 26** | **Investing in Kosovo: Business opportunities and market entry for german companies,** by KDWV in IHK-Bezirkskammer Göppingen |
| **April 30** | **New Members Day, by KDWV** |
| **October 2-3** | **2nd German-Kosovar Economic Forum,** by KDWV |

[Fairs in Germany]

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Në këtë Newsletter, ju sjellim përmbledhjen e aktiviteteve të planifikuara nga OEGJK, si dhe lajmeve të fundit nga anëtarësia; nga Eventi Business After Hours, Publikimi i Studimit "Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-Aged Women in Kosovo", Çertifikimi i kompanisë anëtare Agusholli, Anëtarësia e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) në Europex, e deri tek Ligji i miratuar për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

In this Newsletter, we bring to you the latest news summary of our planned activities from KDWV and news from our member companies; from the Business After Hours networking event, the Publication of the Position Paper: "Challenges of Accessing the Labor Market - Middle-Aged Women in Kosovo", the Certification of the member company Agusholli, Membership of the Albanian Power Exchange (ALPEX) in Europex, to the approved Law on Resources of Renewable Energy.

We thank you for being a part of our community!

### Business After Hours 17.04 | 19:00 | Urban Gastrolounge

OEGJK ka kënaqësinë të ju ftojë në eventin “Business After Hours”, që do të mbahet me datë **17 Prill 2024, nga ora 19:00 deri ora 21:00 në** Urban Gastrolounge**, rr. Mark Sopi 22, Prishtinë.**

Jemi të lumtur që nga ky event i kthyer tashmë në traditë të OEGJK, të ju ofrojmë mundësi për rrjetëzim dhe bashkëpunime të reja.

### Business After Hours 17.04 | 19:00 | Urban Gastrolounge

KDWV is pleased to invite you to the event "Business After Hours" which will be held on **April 17th from 19:00 until 21:00** at Urban Gastrolounge**, Str. Mark Sopi 22, Prishtina**.

We are happy to offer you networking and collaboration opportunities through this event, which has become a tradition of KDWV.

**Eventi sponsorizohet nga kompania jonë anëtare International Tax & Accounting LLC.**

**International Tax & Accounting LLC është kompani, e cila aktivitet primar ka kontabilitetin, këshillimet tatimore dhe financiare. Gjithashtu, ofron konsulencë ligjore, me fokus të veçantë në pronësinë intelektuale. Kompania operon në Kosovë nga viti 2019.**

Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen tuaj deri me datë 16 Prill tek info@oegjk.org.

**The event is sponsored by our member company International Tax & Accounting LLC.**

**International Tax & Accounting LLC is a company whose primary activity is accounting, tax and financial consulting. It also offers legal consultancy, with a special focus on intellectual property. The company has been operating in Kosovo since 2019.**

Please confirm your participation by April $16^{th}$ at info@oegjk.org.

---

**OEGJK dhe FNF kanë realizuar Studimin: „Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-Aged Women in Kosovo"**

Si rezultat i analizave që kanë treguar se diskriminimi i grave të moshës së mesme mund të ndikojë në pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare dhe Fondacioni Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit (FNF), në bashkëpunim me autoret Saxhide Mustafa dhe Shqipe Gjocaj, kanë hulumtuar moshizmin gjinor në tregun e punës në Kosovë.

Eventi publikues i Studimit, ku do të prezantohen të gjeturat e Studimit, do të përcjellet nga **Paneli i Diskutimit: "Perspektivat socio-ekonomike mbi sfidat e punësimit me të cilat përballen gratë e moshës së mesme në Kosovë"** me pjesëmarrjen e akterëve relevantë, që do të shërbejë si platformë diskutimi.
Ju njoftojmë se eventi do të mbahet në gjuhën shqipe, dhe nuk do të ketë përkthim në dispozicion. Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë, ju lutemi të na kontaktoni në: info@oegjk.org

**KDWV and FNF have conducted the Position Paper: "Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-Aged Women in Kosovo"**

As a result of the analyses that indicate that discrimination against middle-aged women, may affect their participation in the labor market, the German-Kosovar Business Association and the Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit (FNF), in collaboration with authors Saxhide Mustafa and Shqipe Gjocaj, have researched gendered ageism in the labour market in Kosovo.

The event where the findings of the Study will be presented, will be accompanied by a **Discussion Panel: "Socio-Economic Perspectives on Employment Challenges Faced by Middle-Aged Women in Kosovo"**, that with the participation of relevant stakeholders will serve as a discussion platform.
Please note that the event will be conducted exclusively in Albanian, and there will be no translation provided. If you're interested in attending, please contact us at: info@oegjk.org

---



**Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) anëtare e plotë në Europex**

Nga data 3 prill 2024, Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) ka fituar statusin e anëtarit të plotë në Europex, që i mundëson të drejtën e votës dhe të drejtën të zgjidhet në organet drejtuese të Europex. ALPEX është sipërmarrje e përbashkët mes operatorit të transmisionit në Shqipëri (OST) dhe atij në Kosovë (KOSTT).

Europex (Shoqata e Shkëmbimeve Evropiane të Energjisë) është shoqata më e rëndësishme e bursave të energjisë elektrike, me fokus në zhvillimin e kornizave rregullative evropiane për tregun e energjisë elektrike. Europex numëron 33 bursa anëtare, përfshirë të gjitha bursat e energjisë elektrike të vendeve të BE-së.

Aktivitetet kryesore të anëtarëve të Europex përfshijnë funksionimin e tregjeve me shumicë të energjisë elektrike, gazit dhe emetimeve në afate kohore afatgjata dhe afatshkurtra.

**ALPEX (Albanian Power Exchange) becomes a full member in Europex**

From the 3rd of April, ALPEX has received full member status in Europex; a status which grants them the right to vote and to be elected to the governing bodies of Europex. ALPEX is a joint venture company between the Transmission System Operator of Albania (OST) and Transmission System and Market Operator of Kosovo (KOSTT).

Europex (Association of European Energy Exchanges) is the most important association of electric energy exchange, that focuses on developing the European regulatory frameworks for the electric energy market. Europex counts 33 member exchanges, including all electricity exchanges of EU countries.

The main activities of Europex members include the operation of wholesale markets for electricity, gas, and emissions in long-term and short-term timeframes.

---

**Miratohet Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë**

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar me shumicë votash Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE).

Përmes këtij Ligji, Kosova krijon një kornizë ligjore që vë burimet e pastra të energjisë në fokus dhe njëherit mundëson tërheqjen e investimeve të reja në linjë me Strategjinë e Energjisë 2022 – 2031.

**The Law on the Promotion of the Use of Renewable Energy Sources was approved**

The Assembly of the Republic of Kosovo has approved the Law on the Promotion of the Use of Renewable Energy Sources (BRE) with a majority of votes.

Through this Law, Kosovo creates a legal framework that brings clean energy sources in focus and at the same time enables the attraction of new investments in line with the Energy Strategy 2022-2031.

---

**N.P.T. FAMILY AGUSHOLLI pajiset me certifikatën e Sistemit të Sigurisë Ushqimore FSSC 22000**

Kompania anëtare e OEGJK, N.P.T. FAMILY AGUSHOLLI, është pajisur me Certifikatën ndërkombëtare të Sistemit të Sigurisë Ushqimore FSSC 22000.

**N.P.T. FAMILY AGUSHOLLI receives the FSSC 22000 Food Safety System certificate**

KDWV member company, N.P.T. FAMILY AGUSHOLLI, has received the international FSSC 22000 Food Safety System Certificate.

Bazuar në standardin e njohur ndërkombëtar, ISO 22000 si dhe standardet teknike si ISO TS 22002-1 për prodhimin e ushqimit dhe ISO TS 22002-4 për prodhimin e paketimit, certifikata FSSC 22000, dëshmon një mbrojtje të lartë të sigurisë ushqimore për konsumatorët.

Based on the recognized international standard, ISO 22000 and technical standards such as ISO TS 22002-1 for food production and ISO TS 22002-4 for packaging production, FSSC 22000 proves a high level of food safety protection for consumers.




**Ruani Datën: Forumi i dytë Ekonomik Gjermano – Kosovar**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare këtë vit sjell edicionin e dytë të Forumit Ekonomik Gjermano-Kosovar, i cili do të mbahet më 2 dhe 3 Tetor 2024 në Prishtinë.

Forumi Ekonomik Gjermano-Kosovar shërben si platformë unike e fuqizimit të raporteve bilaterale ekonomike ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Kosovës duke synuar tërheqjen e investimeve të reja nga Gjermania, ofrimin e mundësisë së zgjerimit të aktiviteteve afariste ndërmjet kompanive kosovare dhe gjermane dhe promovimit të tregut të Kosovës si vend potencial për investime gjermane.

Për detaje rreth Forumit do të ju njoftojmë së shpejti!

#ForumiEkonomikGjermano-Kosovar2024

**Save the Date: 2nd German – Kosovar Economic Forum**

The German-Kosovar Business Association is organizing the second German-Kosovar Economic Forum, which will be held on 2nd and 3rd of October, in Prishtina.

The German-Kosovar Economic Forums serves as a unique platform which aims to strengthen the bilateral economic relations between the Federal Republic of Germany and the Republic of Kosovo, aiming to attract new investments from Germany, offering the possibility of expanding business activities between kosovar and german companies and promoting Kosovo as a pontential country for german investments.

For details on the Forum we'll inform you soon!
Stay tuned!
#German-KosovarEconomicForum2024

**KDWV-OEGJK**
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | April 12th 2024

**YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV**

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**
ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina
Monday – Friday | 8.30 – 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

greta.kazia@oegjk.org



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive

Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant

Senior Expert Service Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve

Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events

Advisor for VET

besarta.hyseni@oegjk.org



**Eriola Muhaxhiri**

Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie Qeveritare

Head of Department for Advocacy and Government Relations

eriola.muhaxhiri@oegjk.org



**Jeta Syla**

Asistente Projekti

Project Assistant

Department for Market Entry & Events

jeta.syla@oegjk.org



**Rreze Gashi**

Koordinatore

Coordinator

Department for Advocacy and Government Relations

rreze.gashi@oegjk.org